



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 50/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit KRU Prishtina Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala” nr. 4, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.B, kundër të paditurit Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, me seli në Prishtinë, rr. “Ali Pashë Tepelena”, nr.1, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.H, për shkak të anulimit të vendimit nr. 08/18 të datës 23.01.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 13.09.2022 në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 27.09.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit KRU Prishtina Sh.A., me të cilën ka kërkuar: “të anulohet vendimi nr. 08/18 i datës 23.01.2018 i nxjerrë nga i padituri Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe të mbetet në fuqi vendimi i paditësit si organ i shkallës së parë”.

A r s y e t i m

Paditësi KRU Prishtina Sh.A., ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) nr. 08/18 i datës 23.01.2018 si kundërligjshëm, me arsyetimin se vendimi i saj ka qenë i bazuar në nenin 29 dhe 35 par.2 të Rregullores nr.02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë dhe në nenin 7.1.7, 7.1.8 dhe 29.2.2 të Rregullores nr. 03/2016 për Kartën e Konsumatorit të Shërbimeve të Ujit në Kosovë. Gjithashtu ka theksuar se në bazë të provave që kanë pasur, kanë konstatuar se ujëmatësi i konsumatorit ka qenë i mbuluar për çfarë teknikisht ka qenë e pamundur që të lexohet shpenzimi i ujit, ndërsa konsumatori ka qenë i obliguar ta mirëmbajë pusetën e tij andaj është sugjeruar që të ju mundësohet qasja në ujëmatës. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare gjykatës i ka propozuar që të aprovohet padia e paditësit ashtu që të shfuqizohet në tërësi vendimi i të paditurës ARRU si i pabazuar ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i shkallës së parë, përkatësisht paditësit KRU Prishtina.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i ARRU-së është nxjerrë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Rregullores nr. 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë si dhe të Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit. Gjithashtu kanë theksuar se e paditura duke u bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se shpenzimi i faturuar nga KRU Prishtina për konsumatorin A.S nuk ka qenë në përputhje me konsumin e matur pasi që me procesverbalin për kontroll dhe inspektim 21/51 të datës 29.11.2017 gjendja e konsumit në ujëmatës ka qenë 878m³, ndërsa gjendja në faturën e konsumatorit me datë 22.11.2017 është regjistruar 1,199m³, andaj kjo tregon mospërputhje të faturimit me gjendjen reale të ujit prej 321m³. Në seancën e shqyrtimit kryesor kanë theksuar se i padituri me vendimin e goditur në këtë procedurë e ka obliguar paditësin që konsumatorin ta faturoj vetëm për shpenzimin e bërë kjo në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve, prandaj gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpapia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i ARRU.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim nr. 08/18 i datës 23.01.2018 i lëshuar nga ARRU, Vendim pa numër, i datës 01.12.2017 i lëshuar nga KRU Prishtina, Lista e konsumatorëve për verifikim, Leximi i ujëmatësve për periudhën 29.09.2017 – 26.10.2017, Formulari i ankesës nr. ref. 182509 i datës 23.11.2017, faturimi për konsumatorin A.S, Fotografii të ujëmatësit, Procesverbal për shqyrtimin e ankesës i datës 01.12.2017, Procesverbal për kontroll dhe inspektim nr. 02871 i datës 29.11.2017, kartela financiare e konsumatorit për periudhën 01.01.2013 deri 22.01.2018, Raport detal mbi ankesën.

Gjykata në rigjykim të çështjes, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës dhe udhëzimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit e Kosovës, gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar.

Me Vendimin e datës 01.12.2017 paditësi KRU Prishtina, ka refuzuar ankesën e konsumatorit me nr. referent 182509 të datës 23.11.2017 lidhur me verifikimin e ujëmatësit individual si të pabazuar.

Konsumatori i pa kënaqur me vendimin, ka ushtruar ankesë në Komisionin Këshillues të Konsumatorëve pranë ARRU-së, të cilët me Vendimin nr. 08/18 të datës 23.01.2018 kanë aprovuar ankesën e konsumatorit A.S me nr. 746 të datës 21.12.2017 për barazimin e

gjendjes së ujëmatësit me faturë. Gjithashtu kanë anuluar Vendimin e paditësit KRU Prishtina dhe e kanë obliguar që të bëjë barazimin e faturimit duke u bazuar në gjendjen faktike të konsumit të ujit në ujëmatës.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 26 par. 1 të Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (si ligj në fuqi në kohën e trajtimit të ankesës në procedurë administrative) që përcakton se: *“1. Autoriteti nxjerr rregullore, për Komisionin këshillues të konsumatorëve.”* dhe par. 2 që përcakton se: *“2. Autoriteti themelon nga një Komision këshillues të konsumatorëve për secilën zonë të shërbimeve, në bashkërendim me komunën përkatëse dhe ofruesin përkatës të shërbimeve me qëllim të: 2.1. konsultimit të konsumatorëve dhe dhënies së rekomandimeve Autoritetit për ndonjë çështje me rëndësi, përkitazi me ofrimin e shërbimeve; 2.2. marrjes së vendimit lidhur me ankesat e shqyrtuara, të cilat nuk janë trajtuar si duhet nga ofruesi i shërbimeve;”*. Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 10 par.1, nën-par. 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr. 01/2016 për Komisionin Këshillues të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit në Kosovë e datës 07 korrik 2016 që përcaktojnë se: *“1. Detyrat kryesore të Komisionit janë: ... 1.2. të shqyrtojë, zgjidh ankesat e parashtruara nga konsumatorët të cilët janë të pakënaqur me vendimet nga Ofruesit e shërbimeve në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi; 1.3. merr vendime lidhur me ankesat e shqyrtuara...”*

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje. Gjykata nga prova Formular i ankesës së konsumatorit nr. 182509 gjykata ka konstatuar se konsumatori A.S me datë 23.11.2017 ka paraqitur tek paditësi ankesë lidhur me gjendjen e shpenzimit të ujit në faturë, ku me datën 22.11.2017 ka pranuar faturën me gjendje 1,199m³, ndërsa në ujëmatës është gjendja 876m³, për çfarë ka kërkuar korrigjimin e shpenzimeve. Nga prova Faturë për konsumatorin A.S, gjykata ka konstatuar se paditësi në periudhën 01.11.2017 deri 30.11.2017 në ujëmatës ka regjistruar vlerën 1,199m³. Nga provat Procesverbal për shqyrtimin e ankesës i datës 01.12.2017 dhe Procesverbal për kontroll dhe inspektim i datës 29.11.2017, gjykata ka konstatuar se gjendja e ujëmatësit në këtë datë ka qenë 878m³.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka aprovuar ankesën e konsumatorit dhe ka anuluar vendimin e paditësit me të cilin ka refuzuar ankesën e konsumatorit pasi që nga vlerësimi i të gjitha provave rezulton se ujëmatësi i konsumatorit deri në periudhën 22.11.2017 ka regjistruar shpenzimin e 876m³

ujë, prandaj faturimi i bërë nga paditësi se ujëmatësi i konsumatorit ka regjistruar shpenzimin e 1,199m2 nuk ka qenë i drejtë.

Gjykata vlerëson se një faturim i tillë nga paditësi ka qenë në kundërshtim me nenin 29 në par. 1 deri 7 të Ligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit i cili përcakton se: *“1. Faturimi i energjisë dhe i ujit llogaritet në bazë të konsumit real të lexuar në njehsorin e konsumatorit. 2. Mënyra e matjes dhe e llogaritjes të energjisë dhe ujit rregullohet me ligje dhe akte tjera nënligjore. 3. Furnizuesi detyrohet që konsumatorit t’ia mundësojë paraprakisht njoftimin me të gjitha kushtet e konsumit të energjisë dhe ujit. 4. Furnizuesi duhet të paraqesë në faturë shënimet që i mundësojnë konsumatorit kontrollin e sasisë dhe vlerës për konsumin e energjisë dhe ujit. 5. Furnizuesi është i detyruar t’u përmbahet standardeve të shkruara të cilësisë dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve të energjisë dhe ujit. 6. Faturimi i energjisë dhe ujit duhet të llogaritet në bazë të konsumit real dhe vlerësohet nëpërmjet njësoreve të kalibruar.”*

Gjithashtu në nenin 29 par.2 nën-par. 2.2 dhe 2.3 të Rregullores nr. 03/2016 për Kartën e Konsumatorit të Shërbimeve të Ujit në Kosovë përcaktohet se: *“Ofruesit e shërbimeve duhet ndaras të specifikojnë tarifën dhe shumën e faturuara për çdo shërbim në çdo faturë të lëshuar: ... 2.2. Shifrën e fundit dhe atë paraprake të leximit të ujëmatësit shprehur në numër, si dhe diferencën e këtyre dy numrave, shprehur në m3 ; 2.3. Sasinë e vlerësuar të harxhimit të ujit shprehur në m3 , në rastet e mungesës apo mos funksionimit të ujëmatësit;”*

Në rastet kur kemi të bëjmë me nën-ngarkim ose mbi-ngarkim të konsumatorit, neni 34 i të njëjtës rregullore përcakton se: *“Ofruesi i shërbimeve do të përmirësojë një faturë në të cilën konsumatori është nën-ngarkuar ose mbi-ngarkuar si pasojë e moszbatimit të tarifave të shërbimit ose gabimeve njerëzore, dhe do të kreditojë ose debitojë, varësisht nga rasti, llogarinë e konsumatorit për një shumë të barabartë me atë si në gabim, brenda njëzet (20) ditë pune nga data kur është zbuluar gabimi ose në rastin e kontestit me konsumatorin, jo më vonë se njëzet (20) ditë pune duke filluar nga data kur kontesti është zgjidhur.”*

Prandaj, gjykata vlerëson se ARRU ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të aprovojë ankesën e konsumatorit për barazimin e gjendjes së ujëmatësit me faturë, të anulojë vendimin 182509/17 të datës 04.12.2017 të KRU Prishtina dhe të obligohet paditësi që të bëjë barazimin e faturimit duke u bazuar në gjendjen faktike të konsumit të ujit në ujëmatës, pasi që paditësi në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ka faturuar shpenzime jo reale të konsumit të ujit.

Me qëllim të trajtimit të udhëzimeve të dhëna nga gjykata e shkallë së dytë në Aktvendimin më të cilin çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, gjykata në seancën e datës 13.09.2022 ka kërkuar nga palët në procedurë që të deklarohen nëse vendim përfundimtar në këtë çështje është vendimi nr. 08/18 i datës 23.01.2018 dhe përfaqësuesit e autorizuar të palëve kanë deklaruar se vendimi nr. 08/18 i datës 23.01.2018 është vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe i atakuar në këtë çështje të konfliktit administrativ.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të administruara në këtë çështje, përkatësisht Lista e konsumatorëve për verifikim, kartela financiare e konsumatorit dhe provën raport detal mbi ankesën, por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për vendosje ndryshe.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet e të autorizuarës së paditësit të dhëna në padi dhe në seancën gjyqësore se konsumatori ka manipuluar ujëmatësin, por të njëjtat pretendime i vlerësoi si të pabazuara për shkak se në rastet e manipulimit të ujëmatësit duhet të iniciohet procedurë penale ndaj konsumatorit, ndërsa në këtë çështje nuk është dorëzuar ndonjë provë për të mbështetur një pretendim të tillë.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.50/22, datë 27.09.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.